



Restaurimi i Kishës së Shën Mërisë, Bishqethëm, Lushnje



SPECIFIKIMET TEKNIKE

Restaurimi i Kishës së Shën Mërisë

fshati Bishqethëm, Lushnje





Restaurimi i Kishës së Shën Mërisë, Bishqethëm, Lushnje



SPECIFIKIME TEKNIKE

SEKSIONI 1.

1. SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

1.1. Kriteret e restaurimit

1. Ruajtja e vlerave autentike që paraqet monumenti (Kompozimi vëllimor, elementët arkitektonikë).
2. Respektimi i fazave të ndryshme të ndërtimit.
3. Konsolidimi i pjesëve të dëmtuara dhe zëvendësimi i elementëve tepër të degraduar të cilët nuk e kryejnë më funksionin e tyre.

REFERENCAT: Publikimet e listuara më poshtë formojnë një pjesë të këtij specifikimi të referencave të zgjeruara. Botimet që janë të referuara në tekst janë të përcaktuara vetëm për gjërat bazë.

Ligjet dhe Normat e aplikuar shqiptare:

- Çdo ndërhyrje e propozuar duhet të jetë në përputhje me parimet e "Kartës Shqiptare të Restaurimit", VKM. Nr.426, 13 Korrik 2007.

- Ligji nr. 27-2018, datë 17.05.2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë".

1.2. Njësitë matëse

Në përgjithësi njësitë matëse të përdorura janë njësi metrike në mm, cm, m, m², m³, Km, N (Njuton), Kg dhe gradë celcius. Pikat dhjetore janë të shkruara si ". ".

1.3. Grafiku i punimeve

Kontraktuesi duhet t'i japë Mbikqyrësi i punimevet një program të plotë duke i treguar rendin, procedurën dhe metodën sipas së cilave, ai propozon të punohet në objekt deri në mbarim të punës.

Informacioni që mban Mbikqyrësi i punimeve duhet të përfshijë:

- vizatime që tregojnë rregullimin e përgjithshëm të terrenit dhe urës dhe të ndonjë strukture tjetër të përkohshme, të cilat ai i propozon për përdorim,
- detaje të vendosjes së strukturave të përkohshme (skeleri, etj.),
- plane të tjera që ai propozon për përfundimin e të gjitha punëve,
- detaje të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe jo të kualifikuar,
- supervizionin e punimeve.

Mënyra dhe rregulli që janë propozuar për të ekzekutuar punimet permanente është temë për t'u rregulluar dhe miratuar nga Mbikqyrësi i punimeve, dhe çmimi i kontratës duhet të jetë i tillë që të përfshijë çdo rregullim të nevojshëm, të kërkuar nga Mbikqyrësi i punimeve gjatë zbatimit të punimeve.





1.4. Punime të gabuara

Çdo punë, që nuk është në përputhje me këto specifikime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë çdo defekt me shpenzimet e veta, sipas projektit.

1.5. Tabelat njoftuese, etj.

Asnjë tabelë njoftuese nuk duhet vendosur, përveç: Kontraktori do të ndërtojë dy tabela, që përmbajnë informacion të dhënë nga Mbikqyrësi i punimeve dhe vendosen në vendet e caktuara nga ai. Fjalët duhen shkruar në mënyrë të tillë, që të jenë të lexueshme nga një distancë prej 50 m. Gjuha e shkruar duhet të jetë në shqip.

1.6. Autorizimet me shkrim

“Rregullat me shkrim” do t’i referohen çdo dokumenti dhe letre të nënshkruar nga Mbikqyrësi i punimeve të dërguara kontraktuesit që përmbajnë instruksione, udhëzime ose orientime për kontraktorin në mënyrë që ai të realizojë ekzekutimin e kësaj kontrate.

Fjalët e aprovuara, të drejtuara, të autorizuar, të kërkuara, të lejuara, të urdhëruara, të instruktuar, të emëruara, të konsideruara të nevojshme, urdhëresa ose jo (duke përfshirë emra, folje, mbiemra, dhe ndajfolje) të një rëndësie, do të kuptohet që aprovimet e shkruara, drejtimet, autorizimet, kërkesat, lejet, rregullat, instruksionet, emërimet, urdhëresat e Mbikqyrësi i punimevet do të përdoren deri në daljen e një plani tjetër pune.

1.7. Kopjimi i vizatimeve (Vizatimet siç është zbatuar)


Kontraktori duhet të përgatisë vizatimet për të gjitha punimet “siç janë zbatuar faktikisht” në terren. Gjatë zbatimit të punimeve në kantier, Kontraktori do të ruajë të gjithë informacionin e nevojshëm për përgatitjen e “Vizatimeve siç është zbatuar”. Do të shënojnë në mënyrë të qartë vizatimet dhe të gjitha dokumentat e tjera të cilat mbulojnë punën e vazhdueshme të përfunduar. Këto vizatime do të azhurnohen në mënyrë të vazhdueshme dhe do t’i dorëzohen Mbikqyrësi i punimevet çdo muaj për aprovim, pasi punimet të kenë përfunduar, së bashku me kopjen përfundimtare. Materiali mujor do të dorëzohet në kopje letër dhe firmosen nga drejtuesi teknik, inxhinieri i kantierit. Vizatimet e riprodhuara do të përfshijnë pozicionin dhe shtrirjen e të gjithë konstruksionit mbajtës të lëna gjatë gërmimeve dhe vendosjen ekzakte të të gjitha shërbimeve që janë ndeshur gjatë ndërtimit. Kontraktori gjithashtu duhet të përgatisë seksionet e profilin gjatësor të rishikuar, pajisur me shënimet që tregojnë shtresat e tokës që hasen gjatë të gjitha punimeve të gërmimit.

Si përfundim, kopjet e riprodhuara të Vizatimeve, “siç është zbatuar” do t’i dorëzohen Mbikqyrësi i punimevet për aprovim. Vizatimet, “siç është zbatuar”, të aprovuara, do të bëhen pronë e Punëdhënësit dhe një kopje origjinale do të depozitohet në Arkivën e IMK-së.

1.8. Vizatimet e punimeve të zbatuara dhe librezat e masave

Kontraktori do t’i përgatisë dhe dorëzojë Mbikqyrësi i punimevet tre grupe të dokumentacioneve të punimeve sipas projektit. Ky material duhet të përmbajë një komplet të vizatimeve të projektit të zbatuar, vizatimet shtesë të bëra gjatë zbatimit të punimeve të aprovuara nga Mbikqyrësi i punimeve, si dhe librezat e masave për çdo volum pune.





1.9. Dorëzimet tek Mbikqyrësi i punimeve

Kontraktori duhet t'i dorëzojë Mbikqyrësi i punimevet për çdo punim shtesë, një vizatim të detajuar dhe puna duhet të fillojë vetëm pas aprovimit nga Mbikqyrësi i punimeve.

Kontraktori duhet të nënshkruajë propozime, detaje, skica, llogaritje, informacione, materiale, çertifikata testi, kurdo që të kërkohen nga Mbikqyrësi i punimeve. Mbikqyrësi i punimeve do të pranojë çdo dorëzim dhe nëse janë të përshtatshme do t'i përgjigjet kontraktorit në përputhje me çdo klauzolë përkatëse të kushteve të kontratës. Çdo pranim duhet bërë me data në marrëveshje me Mbikqyrësi i punimeve dhe duke iu referuar programit të aprovuar dhe kohës së nevojshme që i duhet Mbikqyrësi i punimevet për të bërë këto pranime.

1.10. Mostrat

Kontraktori duhet të sigurojë mostra, të etiketuara sipas të gjitha përshtatjeve, aksesorëve dhe tema të tjera që mund të kërkohen me të drejtë nga Mbikqyrësi i punimeve për inspektim. Mostrat duhen dorëzuar në zyrën e Mbikqyrësi i punimevet.

1.11. Zëvendësimet

Zëvendësimi i materialeve të specifikuar do të bëhet vetëm me aprovimin e Mbikqyrësit të Punimeve. Nëse materiali i propozuar për tu zëvendësuar është i njëjtë ose më i mirë se materialet e specifikuar; ose nëse materialet e specifikuar nuk mund të sillen në sheshin e ndërtimit në kohë për të përfunduar punimet e Kontratës për shkak të kushteve jashtë kontrollit të Kontraktorit, që kjo të merret në konsideratë, kërkesa për zëvendësim do të shoqërohet me një dokument dëshmi të cilësisë.

1.12. Dokumentat dhe vizatimet

Kontraktori do të verifikojë të gjitha dimensionet, sasitë dhe detajet të treguara në Vizatimet, Grafikët, ose të dhëna të tjera dhe Punëdhënësi nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë mangësi ose mospërputhje të gjetur në to. Mos zbulimi ose korigjimi i gabimeve ose mospërputhjeve nuk do ta lehtësojë Kontraktorin nga përgjegjësia për punë të pakënaqëshme. Kontraktori do të marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë në bërjen e llogaritjeve të madhësive, llojeve dhe sasive të materialeve dhe pajisjeve të përfshira në punën që duhet bërë sipas Kontratës. Ai nuk do të lejohet të ketë avantazhe nga ndonjë gabim ose mospërputhje, ndërsa një udhëzim i plotë do të jepet nga Punëdhënësi nëse gabime të tilla ose mospërputhje do të zbulohen.

1.13. Fotografitë e sheshit të ndërtimit

Kontraktori duhet të bëjë fotografi me ngjyra sipas udhëzimeve të Mbikqyrësit të Punimeve në vendet e punës për të demonstruar kushtet e objektit përpara fillimit, progresin gjatë punës së konservimit dhe mbas përfundimit të punimeve restauruese.

1.14. Bashkëpunimi në zonë

Restaurimi do të bëhet në zona të kufizuara. Kontraktori duhet të ketë veçanërisht kujdes në:

- Nevojën për të mirëmbajtur shërbimet ekzistuese dhe mundësitë e kalimit për punonjësit, gjatë periudhës së restaurimit të urës.





- Prezencën e mundëshme të kontraktorëve të tjerë në zonë me të cilët do të koordinohet puna.

E gjithë puna, do të bëhet në një mënyrë të tillë, që të lejojë hyrjen dhe përballimin e të gjithë pajisjeve të mundëshme për ndonjë Kontraktor tjetër dhe punëtorëve të tij si dhe stafin e Punëdhënësit.

Në përgatitjen e programit të tij të punës, Kontraktori gjatë gjithë kohës do të bëjë llogari të plotë dhe do të koepërojë me programin e punës së Kontraktorëve të tjerë, në mënyrë që të shkaktojë një minimum interference me ta dhe me publikun.

1.15. Mbrojtja e punës dhe e publikut

Kontraktori do të marrë masa paraprake për mbrojtjen e punëtorëve të punësuar dhe të jetës publike rreth sheshit të punimeve. Masat e sigurimit paraprak të ligjeve të aplikushme, kodeve të ndërtimit do të respektohen. Makineritë, pajisjet dhe çdo rrezik do të kqyren ose eliminohen në përputhje me masat paraprake të sigurimit.

Gjatë zbatimit të punimeve Kontraktori duhet të vendosë dhe të mirëmbajë gjatë natës pengesa të tilla dhe drita të cilat do të parandalojnë në mënyrë efektive aksidentet. Kontraktori duhet të sigurojë pengesa të përshtatëshme, shenja me dritë të kuqe "rrezik" ose "kujdes" dhe vrojtues në të gjitha vendet ku punimet mund të përbëjnë në ndonjë mënyrë rrezik për publikun.

1.16. Mbrojtja e ambjentit

Kontraktori duhet të ndërmarrë të gjithë veprimet e mundëshme për të siguruar që ambjenti lokal i sheshit të ruhet dhe që vijat e ujit, toka dhe ajri (duke përfshirë edhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera.

1.17. Transporti dhe magazinimi i materialeve

Transporti i çdo materiali nga Kontraktori, do të bëhet me makina të përshtatëshme, të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar gjithashtu dhe me kafshë pune. Ndonjë makinë që nuk plotëson këtë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantjeri. Të gjitha materialet që sillen nga Kontraktori, duhet të stivohen ose të magazinohen në mënyrë të përshtatëshme për t'i mbrojtur nga rrëshqitjet, dëmtimet, thyerjet, vjedhjet dhe në dispozicion, për tu kontrolluar nga Mbikqyrësi i Punimeve në çdo kohë.

1.18. Pastrimi përfundimtar i zonës

Në përfundim të punës, sa herë që është e aplikueshme Kontraktori duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjitha impiantet ndërtimore, materialet që kanë tepruar, mbeturinat, skeleritë dhe ndërtimet e përkohëshme të çdo lloji dhe të lërë sheshin e lirë dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme.





SEKSIONI 2. PUNIME PRISHJEJE-ÇMONTIMI DHE PASTRIMI

2. TË PËRGJITHSHME

KËRKESAT: Puna përfshin çmontimin dhe largimin e të gjitha materialeve të diktura ose të specifikuara. Punimet e cta nuk do të fillojnë deri sa autorizimi të merret nga Mbikqyrësi. Të gjitha materialet që rezultojnë nga prishja apo çmontimi, përveç nëse tregohet apo të specifikohet ndryshe, do të largohen nga kufijtë e sheshit. Mbeturinat do të hiqen nga kantieri çdo ditë, përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Mbikqyrësi; akumulimi i materialit të tillë është i ndaluar. Materialet të cilat nuk mund të hiqen brenda ditës do të ruhen në mënyrë të përshtatshme në zonat e përcaktuara. Nëse Kontraktuesi identifikon kalbësira në dru gjatë punimeve të çmontimit ai do të marrë masat e duhura për sigurinë e shëndetit. Njoftohet menjëherë Mbikqyrësi dhe i propozohen masa të përshtatshme për miratim. Kontraktuesi duhet të paraqesë prova për asgjësimin e duhur të materialeve me kërkesë të Mbikqyrësit.

Mbrojtja e vendit të pastruar

Sipërmarrësi i punimeve duhet të ngrejë rrjetë të përshtatshme, barriera mbrojtëse, në mënyrë që të parandalojë aksidentime të personave ose dëmtime të godinave rrethuese nga materialet që bien, si dhe të mbajë nën kontroll territorin, ku do të kryhen punimet.

Skeleritë:

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH. Një skelator kompetent dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi. Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copërave të mbledhura mbi një skeleri, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar. Duhet marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skelës. Skeleritë duhen të jenë gjatë kohës së përdorimit të përshtatshme për qëllimin për të cilin do përdoren dhe duhet të jenë konform të gjitha kushteve teknike.

2.1 PUNIME PRISHJEJE

2.1.1 Skeleritë:

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH. Një skelator kompetent dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi. Kontraktori duhet të sigurojë, që të gjitha rregullimet e nevojshme, që i janë kërkuar skelatorit të sigurojnë stabilitetin gjatë kryerjes së punës. Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copërave të mbledhura mbi një skeleri, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar. Duhet marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skelës. Skeleritë duhen të jenë gjatë kohës së përdorimit të përshtatshme për qëllimin për të cilin do përdoren dhe duhet të jenë konform të gjitha kushteve teknike.

Skeleri çeliku të tipit këmbalec, konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parmakë vertikalë, më lartësi min.15 cm si dhe mbrojtjen me rrjetë.





Restaurimi i Kishës së Shën Mërisë, Bishqethëm, Lushnje



Skeleri çeliku në kornizë dhe e lidhur, konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parmakë vertikalë, me lartësi min.15 cm si dhe mbrojtjen me rrjetë.

2.1.2 Mbikqyrja

Kontraktori duhet të ngarkojë një person kompetent dhe me eksperiencë, të trajnuar në llojin e punës për ngritjen e skelerive dhe të mbikëqyrë punën për ngritjen e skelave në kantier.

2.1.3 Metoda e prishjes

Puna për prishje do të fillojë vetëm pasi të jenë stakuar energjia elektrike dhe rrjete të tjera të instalimeve ekzistuese të objekteve. Metodën e prishjes së pjesshme, duhet të jenë të tilla që pjesa e strukturës që ka mbetur të sigurojë qëndrueshmërinë statike të objektit. Kur prishja e elementeve nuk mund të bëhet pa probleme e ndarë nga pjesa e strukturës do të përdoret një metodë pune e përshtatshme. Elementët e drurit mund të hidhen nga lart, vetëm kur ato nuk paraqesin rrezik për pjesën tjetër të strukturës. Kur prishen elementët, duhen marrë masa për të mos rrezikuar elementët e tjerë konstruktive mbajtës, si dhe mos dëmtohen elementët e tjerë. Në përgjithësi, puna e çmontimit duhet të fillojë duke hequr sa më shumë ngarkesa të panevojshme, *pa ndërhyrë në elementët bazë struktural*. Punë të kujdesshme do të bëhen për të hequr ngarkesat kryesore nën kushtet më të vështira. Seksionet të tjera që do të prishen do të ndahen dhe do të ulen në tokë nën kontroll.

2.2 PASTRIMI I KANTIERIT

2.2.1 Pastrimi i kantierit:

Në fillim të kontratës, për sa kohë që ajo nuk ka ndryshuar, kontraktori duhet të heqë nga territori i punimeve të gjitha materialet organike vegjetare dhe ndërtuese, dhe të djegë të gjitha pirgjet e mbeturinave të tjera.

2.2.2 Mbrojtja e objekteve, rrethimeve dhe strukturave:

Gjatë kryerjes të punimeve prishëse, kontraktuesi duhet të marrë masa që të mbrojnë strukturat që gjenden në afërsi të objektit, ku po kryhen këto punime prishëse.

Për këtë, duhen evituar mbingarkesat nga të gjitha anët e strukturave nga grumbuj dhe materiale. Kur grumbujt dhe materialet duhen zbritur poshtë, duhet pasur kujdes që të parandalohet shpërndarja ose rënia e materialeve, ose të projektohet në mënyrë të tillë, që mos të përbëjë rrezik për njerëzit, strukturat rrethuese të çdo lloji. Duhet bërë kujdes nga kontakti me kabllot elektrik.

2.2.3 Mbrojtja e vendit të pastruar:

Kontraktori duhet të ngrejë rrjetë të përshtatshme, barriera mbrojtëse, në mënyrë që, të parandalojë aksidentime të personave ose dëmtime të godinave rrethuese nga materialët që bien, si dhe të mbajë nën kontroll territorin, ku do të kryhen punimet.





SEKSIONI 3. NDËRHYRJE KONSERVUESE DHE RESTAURUESE

3.1 TË PËRGJITHSHME

Çdo ndërhyrje e propozuar duhet të jetë në përputhje me Projektin e miratuar në KKR si dhe parimet e "Kartës Shqiptare të Restaurimit" – VKM Nr.426 on 13 Korrik 2007.

3.2 NDËRHYRJET NË "MONUMENTET E KULTURËS"

Teknikat e ndërhyrjeve që do përdoren në monumentet e kulturës duhet të respektojnë karakteristikat historike, artistike, arkitektonike dhe shpërndarjen e tyre. Kjo do të thotë që përmirësimi duhet të realizohet pa prodhuar modifikime substanciale në sjelljen e strukturës dhe ndërtesës duke përdorur për sa është e mundur teknika ndërhyrje dhe metodologji operative tradicionale, konservim të materies, kushteve fizike dhe morfologjike. Teknika dhe materiale me karakter reversibël edhe pjesor që përdoren në mënyrë diskrete, jo evazive dhe në koherencë me llogjikën konstruktive të strukturës ekzistuese.

3.3 SPECIFIKIMET E NDËRHYRJEVE RESTAURUESE

I. PUNIME SKELERI-TRANSPORT

1.1 Sondazh për themele (gërmim për verifikimin e thellësisë së themeleve) (R.3)

Ky çmim parashikon sondazh për themele në zonat ku do të bëhet gërmimi i dheut, për të evidentuar gjurmët e strukturës dhe për të verifikuar themelet nëse janë të mjaftueshme për muratura të tilla dhe nëse çarjet vertikale vazhdojnë deri në bazament. Sondazhet do të bëhen në pikat e paraqitura në fletët teknike. Gjatë sondazhit arkeologjik dhe gjatë procesit të gërmimit i pranishëm në terren duhet të jetë specialisti arkeolog.

Ky zë pune përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe çmimi i tij është për njësi Lekë/ m³.

1.2 Transport materiale ndërtimi, dheu dhe mbeturina me auto deri në 5.0 km (2.37/5a)

Materialet që do hiqen nga objekti apo akumulimi i inerteve, dherat e lëvizura, do të hiqen në mënyrë manuale me lopatë dhe largimi i tyre nga kantieri deri te mjeti i transportit do të bëhet me karro dore. Dherat e pastruar si dhe materialet inerte do të largohen nga kantieri me automjet. Transporti i çdo materiali nga Kontraktori, do të bëhet me makina të përshtatshme, të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Ndonjë makinë që nuk plotëson këtë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantieri.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkim i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia deri në 5 km larg nga kantieri.

Ky zë pune përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe çmimi i tij është për njësi Lekë/ m³.

II. PUNIME RESTAURIMI

2.1 Pastrim i fasadës nga pluhuri dhe depozitimet sipërfaqësore me ujë me pompë me presion (idropultrici) – fasada lindore (R.132)

Sipërfaqja e muraturës që është e pasuvatuar duhet të pastrohet nga pluhurat dhe depozitimet sipërfaqësore. Pastrimi bëhet me pompë me ujë me presion dhe duhet të bëhet duke rregulluar më parë presionin e ujit. Ky pastrim përveç depozitimeve sipërfaqësore bën edhe pastrimin e materialit të llaçit që mund të jetë shkëputur ose pluhurizuar në fuga midis gurëve. Pas këtij procesi mund të mbushen fugat në të cilat mund të ketë shkëputje të konsiderueshme të llaçit.





Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

2.2 Suva brenda mur guri me krah, llaç gëlqere 1:2 (R.88)

Sipërfaqja e suvatuar do të kontrollohet e gjitha duke evidentuar suvatimin e shkëputur te pa pikturuar, i cili do të prishet deri në gur. Do të evidentohen çarje të mundshme. Muret do të lahen me ujë të bollshëm duke pastruar sipërfaqen nga pluhurat. Fillimisht do të kryhen stukimet, qepjet e çarjeve të mundshme dhe sistemimi i sipërfaqeve ku është e nevojshme, për suvatime për nivelimet e parregullsive, me anë të mbushjes me llaç gëlqere 1:3 me më shumë shtresa edhe për zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht stukimin. Përpara se të vendoset shtresa e suvasë duhet që sipërfaqja që do të suvatohet të laget mirë me ujë. Llaçi i suvasë nuk duhet të aplikohet në tm ≤5C.

Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2cm llaçi gëlqere 1:3 i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5m), dhe e lëmuar me mistri e përdaf, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

Llaç gëlqere ajrore duhet të ketë këto karakteristika:

- Kufiri i rezistencës në shtypje 25 kg/cm²,
- Pesha volumore 1800 kg/m³,
- Konsistenca ≤8
- Papastërtia e rërës 12 %,
- Moduli 1.8
- Raporti G:R 1:3

Rëra për suva duhet të jetë e përbërë nga kokrriza të dimensioneve të tilla për të kaluar në sitë me përmasa 1mm.

Në këtë zë punimesh përfshihen çmimet që duhen për të realizuar sipas kushteve teknike riparimet e suvatimeve të mureve të brendshme prej guri, përgatitja e sipërfaqes së murit pastrimi nga pluhuri, lagia, vendosja e shtresës së suvasë deri në tharje, dora e dytë, dhe finoja, skeleritë e nevojshme. Në çmim përfshihet blerja e të gjitha materialeve të nevojshme me cilësi, transporti i tyre, skeleri, përpunimi dhe vendosja në objekt, ngarkim shkarkimi dhe çdo punë që lidhet me të.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m²

2.3 Suva e zakonshme fasade, mur guri, llaç gëlqere 1:2 (R.91)

Ky zë përfshin furnizimin me lëndë të parë, përgatitjen në kantier dhe aplikimin e suvasë në vepër.

Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi gëlqere 1:3, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m), dhe e lëmuar me mistri e bërda, duke përfshirë skelat e shërbimit, transporti i materialeve si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

2.4 Prishje suvatimi (punimi përfshin dhe pastrimin e fugave në pjesët ku suvatimi mungon) (R.121)

Prishjet e suvatimit përfshijnë goditje të sipërfaqes së suvatuar dhe gjetje të pjesëve të mbufatura dhe të plasaritura nëpërmjet tingullit, prishjen e këtyre pjesëve deri në daljen e muraturës së gurit.





larje të sipërfaqeve të prishura me ujë me presion, spostimin e mbeturinave për pastrimin e ambientit dhe çdo detyrim tjetër për ti dhënë plotësisht fund heqjes së suvasë së dëmtuar.
Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

2.5 Pastrim i suvatimit dhe mbushjeve me llaç në muret e jashtme (heqja e llaçit të çimentos) (R.213)

Prishjet e fuqitimit me llaç çimento, sipas fletëve grafike ku specifikohet. Ky proces përfshin goditje mekanike me spatul të sipërfaqes së fugatuar me llaç çimento, deri në thellësinë ku do të ndeshet llaç i mirë, larje të sipërfaqeve të prishura me ujë me presion, spostimin e mbeturinave për pastrimin e ambientit dhe çdo detyrim tjetër për ti dhënë plotësisht fund heqjes së suvasë së dëmtuar.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

2.6 Prishje suvatimi në fasadë (R.241)

Para se të fillohen punimet aty ku tregohet në plane apo udhëzohet nga Supervizori i objektit, Sipërmarrësi do të kontrollojë në objekt të gjithë sipërfaqen me suva të degraduar. Sipërfaqja e suvatuar do të kontrollohet e gjitha duke evidentuar suvatimin e shkëputur, i cili do të prishet deri në gur. Prishja e suvasë së dëmtuar do bëhet me shumë kujdes në mënyrë që të mos humbasim ndonjë gjurmë të mundshme që mund të fshihet poshtë saj. Suvatë do të kontrollohen dhe në prezencë të mbikqyrësit të punimeve në mënyrë që të gjykojë shkallën e ndërhyrjes. Në prezencë të Supervizorit të punimeve mbahet një proces-verbal për sasinë e sipërfaqes të cilës do ti hiqet suvaja e degraduar. Sipërmarrësi do të realizojë prishjen e të gjithë sipërfaqes me suva të degraduar. Gjatë procesit të prishjes duhet të kihet kujdes që të mos dëmtohen detajet arkitektonike. Sipërmarrësi do të heqë të gjitha copat dhe lëndët organike që rezultojnë nga prishjet në vendin e punës dhe do ti hedhin ato në përputhje me ligjet e shtetit, planin e menaxhimit mjedisor dhe me kërkesat e këtij specifikimi. Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për pastrimin dhe heqjen e kujdesshme të shtresës së suvasë së dëmtuar, skeleri si dhe transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

2.7 Riparim, suvatimi dhe retukimi i pjesëve të dëmtuara të suvasë me llaç gëlqere (R.192)

Para se të fillohen punimet aty ku tregohet në plane apo udhëzohet nga Supervizori i objektit, Sipërmarrësi do të kontrollojë në objekt të gjithë zonat në të cilat suvatimi ka nevojë për riparime dhe dëmtime. Në prezencë të Supervizorit të punimeve mbahet një proces-verbal për sasinë e sipërfaqes ku do të realizohet ndërhyrja. Suvaja e degraduar duhet të jetë hequr deri në muraturë dhe muratura të jetë e larë me ujë me presion. Do të evidentohen çarje të mundshme në fasadë. Fasadat do të lahen me ujë të bollshëm duke pastruar sipërfaqen nga pluhurat. Fillimisht do të kryhen stukimet, qepjet e çarjeve të mundshme dhe sistemimi i sipërfaqeve ku është i nevojshme, për suvatime për nivelimet e parregullsive, me anë të mbushjes me llaç gëlqere me më shumë shtresa edhe për zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht stukimin.

Në këtë zë punimesh përfshihen çmimet që duhen për të realizuar sipas kushteve teknike riparimet e suvatimeve. Në çmim përfshihet blerja e të gjitha materialeve të nevojshme me cilësi, transporti i tyre, skeleri, përpunimi dhe vendosja në objekt, ngarkim shkarkimi dhe çdo punë që lidhet me të.





Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

2.8 Restaurim karrike druri, kishe (20% e materialit drusor) (R.180)

Përfshin pastrimin e sipërfaqes së drurit të karrikeve ekzistuese, zmerilim, zvendesimin e elementeve të demtuar, trajtimin me antimol, vaj lini dhe 2 duar llak sipas ngjyres ekzistuese.

Ky çmim përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe jepet për njësi Lekë/copë.

2.9 Fugatim muri (pastrim mekanik+larje me ujë+fugatim) (R.25)

Fugatime do të kryhen në ato raste kur çarjet (fisurat) janë deri të një madhësie mesatare dhe kur vërehet se llaçi ekzistues është i degraduar.

Fugatimi do të bëhet edhe për eliminimin e fugave të papërshtatshme, fuga të bëra me llaça të fortë me përbërje çimento. Këto llaça nuk përputhen me aparatin e muraturës dhe mund të krijojnë me kalimin e kohës stres mekanik të dukshëm, duke përkeqësuar gjendjen e muraturës.

Fugatimi do të fillojë me pastrimin mekanik (gërryerjen) të fugave nga llaçi degraduar. Pas pastrimit mekanik të fugës dhe larjes me ujë të bollshëm do të kryhet mbyllja e fugave. Masa e llaçit të përgatitur, duhet të jetë homogjen dhe uniform. Fugatimi do të kryhet me llaç gëlqere të majmë, me konsistencë të ulët. Mbas fillon prezën llaçi, atëhere ai laget dhe fërkohet me furçë teli për të eliminuar plasaritjet eventuale të tij. Është e rëndësishme të bëhen analiza të miratuara, për të mësuar përbërjen kimiko-fizike të llaçit ekzistues në mënyrë që të përcaktosh qartësisht natyrën, prejardhjen dhe granulometrinë e materialit të përdorur. Përbërja e llaçit duhet të jetë me material analog të atij ekzistues. Përbërja e llaçit të fugave do të pranohet nga mbikqyrësi i punimeve pas provave dhe marrjes së kampionëve në vend dhe nga rezolucioni kromatik që duhet të arrihet në ngjashmëri me llaçin ekzistues. Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për pastrimin dhe heqjen e kujdesshme të shtresës së llaçit në fugat me furçë teli të ashpër dhe largimin e mbeturinave nga objekti, transporti i materialeve dhe gjithçka duhet për përfundimin e këtij procesi.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

2.10 F.v. breza druri druri pishe stazhionuar (R.165)

Ky zë parashikon vendosjen e brezave të drurit antisizmik aty ku mungojnë, siç është parashikuar në fletët grafike. Çmimi parashikon blerjen, trajtimin e brezit me lyerje antimol, vendosjen në vepër të materialit.

Brezat e drurit do të kenë seksione të njëjta me ato që ndodhen në muraturë. Vendosja e tyre do të bëhet duke hequr një rresht të gurëve të muraturës përgjatë vendit ku brezi mungon, deri aty ku fillon brezi i drurit ekzistues, për të bërë lidhjen me ta. Gjatë procesit të çmontimit të gurëve do të kontrollohet edhe nëse brezat tërthorë janë në vend dhe nëse janë funksionale.

Ky zë përfshin edhe vendosjen e brezave tërthorë nëse ka mangësi, për të krijuar lidhje të mirë.

Procesi i heqjes së rradhës së gurëve duhet të kryhet me kujdes, dhe në prani të supervisorit.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³.

2.11 Mur guri themel e xokol me llaç gëlqere M-15 (plotësime për themelet) (R.6)

Ky zë përfshin ndërtimin e murit themel e xokol për plotësimet e mundshme për themelet me material guri dhe llaç të përzierë M25. Ky çmim përfshin ndërtimin e themelit dhe bazamentin prej guri të lidhur me llaç çimento, përmasat e gurit jo më e vogël se 20 cm në raporte për m3: 0,11 m3





llaç çimento e përzierë M25 për çdo 1 m³ mur guri, duke përfshirë kallëpet, përforcimet dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për kryerjen e këtij procesi.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³.

2.12 Konsolidim strukturor i muraturave prej guri (me dy parete dhe mbushje në mes) me teknikën e injektimit (R.245)

Injektimet do të kryhen kryesisht në zonat ku çarjet e strukturës shfaqen më të dendura dhe mbasi janë bërë fugatimet. Mbas pastrimit të muraturës nga llaçi i dekompozuar dhe para fugatimit vendosen tubat që do të shërbejnë për injektim dhe lahet muratura, si nga jashtë, ashtu dhe brendësia e saj nëpërmjet tubave të injektimit. Tubat do të jenë 1/2" dhe do të vendosen 2-4 copë/m² dhe 25-30 cm në thellësi të muraturës.

Llaçi i injektimit do të përbëhet prej materialesh tradicionale dhe me rezistencë jo më të madhe se llaçi i shëndoshë i muraturës, për të shmangur rrezikun e krijimit të bërthamave rigjide brenda masës së muraturës. Injektimi do të kryhet me gravitacion, d.m.th. me vetërrjedhje dhe në një drejtim, duke filluar nga pjesët e poshtme të muraturës dhe duke u ngjitur në lartësi.

Ky proces do të kryhet nga specialisti restaurator në prezencë të mbikqyrësit të punimeve.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

2.13 Konsolidim strukturor i muraturave prej guri (me dy parete dhe mbushje në mes) i afreskuar me teknikën e injektimit të mishelës me rezistencë të lartë mekanike dhe përbërje të ulët të kripave të tretshme në ujë (carja muri perëndimor i naosit) (R.22)

Ky proces duhet të kryhet me shumë kujdes dhe në mënyrë graduale e të kontrolluar në anët e murit me pikturë në menyre që sapo të vihen re njolla të nderpritet menjëherë deri sa të realizohet rënia e llaçit të hedhur dhe ngrirja e tij, pastaj të vazhdohet me kujdes hedhje në sasi të vogla të llaçit me rënie të lirë nga lart.

Përbërja e llaçit duhet të jetë pa kimikate që dëmtojnë pikturën.

- Rërë lumi e larë	2 pjesë
- Rërë vullkanike me granulacion 0,5-1 cm	2 pjesë
- Pluhur tulle dhe copa tulle deri në 2 cm	2 pjesë
- Gëlqere e vjetër	3 pjesë

Procesi i punës duhet të bëhet në prani të Supervizorit dhe Specialistit për Pikturën Murale.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³.

2.14 Ndërtim çatma skelet druri e suvatim me qull gëlqere, kashtë, litarë (kolonat e naosit) (R.156)

Ky zë parashikon plotësimin me muraturë çatmaje në këmbët e kolonave të cilat janë të betonuara. Ndërtimi i çatmasë, do të fillojë pas pastrimit nga veshja me beton të bazamentit të kolonës, heqjen e të gjitha mbetjeve në këmbët e kolonave dhe pastrimin dhe konsolidimin e drurit e në fund trajtimin me antimol dhe vaj lini, të kolonave të drurit që janë të ekspozuara. Pas kësaj, do të kontrollohet nëse pjesa e çatmasë ekzistuese ka dëmtime ose jo.

Në fund do të fillojë realizimi i veshjes së kolonës me muraturë çatmaje, e cila përveç listelave duhet të ketë edhe litarë rreth saj për përforsim dhe lidhja e tyre do të mbushet me lidhës me dy





duar llaç: një llaç gëlqere me kashtë dhe një shtresë me llaç gëlqere. Në fund do të bëhet suvatimi.
Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

2.15 Shtresë tulla të plota (rate) mbi rërë (R.73)

Plotësimi i shtresës së dyshemesë së hajatit, aty ku mungon, do të bëhet me shtresë nme tulla, të ngjashëm me shtrimin origjinal që ndodhet në hajat. Punimet do të kryhen në këtë mënyrë: Pasi të pastrohet dhe nivelohet, shtresa e dyshemesë, përmbi bazën do të vendohet një shtresë rëre me një trashësi maksimale prej 5 cm, dhe mbi të do të vendosen shtresa e tullave. Shtresa e rërës duhet të jetë me kokriza 2/5 mm deri 0/4 mm. Ajo do të rrafshohet dhe mbi të duhet të vendosen tullat. Në fund fugat e tullave do të mbushen me rërë të imët 0/1 mm në atë mënyrë që tulla të lidhen më së miri njëra me tjetrën dhe të përforcohet/stabilizohet shtresa e tyre.
Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

2.16 Konsolidim i drurit (An-6)

Konsolidimi (petrifikimi i strukturës së drurit) do të kryhet duke përdorur Paraloid B72 të tretur në Açeton në masën 3-4%. Ky raport do të jetë i ndryshueshëm sipas rastit dhe gjëndjes së drurit. Ky raport lejon frymëmarrjen e drurit si dhe konsolidimin e tij nga anën strukturore.
Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

2.17 Prishje e murit mbajtës së depozitës në hajat (2.426/2)

Ky zë parashikon heqjen e blloqeve prej betoni që ndodhen në hajat, të cilat mbajnë depozitën e ujit dhe largimin e tyre në venddepozitimet e përcaktuara nga Bashkia. Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për heqjen dhe transportin e blloqeve dhe ngarkim shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia deri në 5 km larg nga kantieri.
Ky çmim është për njësi Lekë/ m³.

3 PUNIME DYER DRITARE

3.1 Restaurim dyer druri (R.103)

Restaurimi do të fillojë:

- Zëvendësimin e plotë ose të pjesshëm të pjesëve që mungojnë ose të prishura me dru të njëjtë, të stazhionuar dhe me përmasa si të seksioneve ekzistuese
- Zdrukthimi i të gjitha pjesëve të deformuara
- Stukimin e çdo plasaritje me stuko të përshtatshme të së njëjtës ngjyrë me atë të drurit
- Verifikimin, dhe zëvendësimin e mundshëm të gjitha menteshave dhe të gjitha pjesëve të tjera përbërëse
- Vendosjen në vepër të dyerve të riparuar dhe nëse është e nevojshme edhe punime murature, çdo detyrim tjetër të nevojshëm për të siguruar funksionimin e plotë të tyre
- përgatitjen dhe lyerjen me bojë të dyerve, skelat e shërbimit ose skelerine, punimet e muraturës si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës

Trajtimi i sipërfaqeve të drurit:

- Pastrimi i sipërfaqeve nga lyerjet e vjetra të degraduara me furçë të ashpër
- Pastrim me kompresë me ujë të ngrohtë





Restaurimi i Kishës së Shën Mërisë, Bishqethëm, Lushnje



- Pastrim me garzë me alkool të holluar
- Lyerja me 1 dorë solucion antimolë, anti lagështi
- Lyerja me 2 dyar vaj lini
- Lyeje me llak

Ky çmim është lekë/ m².

3.2 Restaurim dritare druri (R.99/1)

Restaurimi do të fillojë me proceset si më poshtë:

- Zëvendësimin e plotë ose të pjesshëm të pjesëve që mungojnë ose të prishura me dru të njëjtë, të stazhionuar dhe me përmasa si të seksioneve ekzistuese.
- Zdrukthimi i të gjitha pjesëve të deformuara.
- Stukimin e çdo plasaritje me stuko të përshtatshme të së njëjtës ngjyrë me atë të drurit.
- Verifikimin, dhe zëvendësimin e mundshëm të gjitha menteshave dhe të gjitha pjesëve të tjera përbërëse.
- përgatitjen dhe lyerjen me bojë, skelat e shërbimit ose skelerinë, punimet e muraturës si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës.

Trajtimi i sipërfaqeve të drurit:

- Pastrimi i sipërfaqeve nga lyerjet e vjetra të degraduara me furçë të ashpër.
- Pastrim me kompresa me ujë të ngrohtë.
- Pastrim me garzë me alkool të holluar.
- Lyerja me 1 dorë solucion antimolë, anti lagështi
- Lyerja me 2 duar vaj lini.
- Lyerje me llak

Ky çmim është lekë/ m².

3.3 F.V.Dritare druri kasë binar teke xham (R.98)

Ky zë përfshin:

- Furnizim dhe vendosje në vepër të dritareve të drurit, me tek xham, konfiguracioni dhe përmasat e së cilave janë sipas V.T. dhe realizohen nga prodhuesi në vendin e prodhimit, në dru pishe të stazhionuar, i imprenjuar dhe përbëhet nga:
- një kontratelajo dërrase (me gjerësi 3 cm, me madhësi sa kasa e dritares) që do të vendoset në mur me fasheta hekuri përpara punimeve të suvatimit.
- një telajo dërrase (me seksione min 7x4cm) që do të vidhohet në kontratelajo pas kryerjes së suvatimit dhe bojatisjes.
- shirita druri të plotë rreth perimetrit të dritares nga brenda, kur realizohen me paturë dhe nga brenda e jashtë në mungesë të paturës (dhëmbit)
- duke përfshirë bërjen e shpatullave të muraturës, si dhe çdo pajisje tjetër për mbarimin e punës në mënyrë precise.


Kampion të artikujve të propozuar do t'i paraqiten Supervizorit të Kantjerit për aprovim paraprak.

Karakteristikat e drurit të pishës duhet të jenë si më poshtë:

- Lagështira jo më e lartë se 7%
- Pesha volumore rreth 450-540kg/m³
- Kufiri I rezistencës në tërheqje rreth 130MPa

Ky çmim është lekë/ m².





3.4 Heqje dyer dritare (R.98/1)

Ky çmim përfshin:

- Heqjen e tyre nga muratura, të specifikuar në fletët grafike. Heqja e dyerve do të bëhet e kujdeshme në mënyrë që lënda autentike në gjendje të mirë të mund të ripërdoret.
- Kontrollin e gjendjes së lëndës drusore, nëse mund të ripërdoret ose jo
- Ruajtjen dhe magazinimin e lëndës që do të ripërdoren
- Largimin nga kantieri i lëndës që nuk do të ripërdoren
- Ngarkimin e materialeve që rezultojnë nga prishja

Ky çmim është lekë/ m².

2.1 F.V.Dyer druri (R.101)

Ky çmim përfshin furnizimin me lëndë të parë si dhe montimin e tij në vepër:

- Furnizim dhe vendosje në vepër dyerve të drurit (me një kanat), konfiguracioni dhe përmasat e së cilave sipas V.T.
- një kontra telajo në dru pishe të stazhionuar (me trashësi 3 cm) e imprenjuar, me përmasa sipas gjerësisë së murit, që do të fiksohet në mure me fasheta të përshtatshme hekuri (çdo 1 m) dhe me llaç
- një telajo druri, që do të vidhoset në kontratelajo pas punimeve të suvatimit, sipas vizatimit të derës në V.T., telajoja do të pajiset me mentesha dhe bllokuese të përshtatshme sipas tipit të derës, etj.
- e gjithë vepra e muraturës si dhe çdo pajisje tjetër për mbarimin e punës në mënyrë perfekte.

Kampion të artikujve të propozuar do t'i paraqiten Supervizorit të Kantjerit për aprovim paraprak.

Karakteristikat e drurit të pishës duhet të jenë si më poshtë:

- Lagështira jo më e lartë se 7%
- Pesha volumore rreth 450-540kg/m³
- Kufiri i rezistencës në tërheqje rreth 130MPa

Ky çmim është lekë/ m².

2.2 Lyerje sipërfaqe druri me antimol (R.107)

Mbrojtja e drurit nga mikroorganizmat dhe insektet të natyrave të ndryshme, kërkon ndërhyrje të niveleve të ndryshme: eliminim të substancave të alterueshme që përmban druri, apo mbrojtja e tij me insekticid që përveç se pengojnë rritjen e mikroorganizmave, kërpudhave dhe insekteve mund edhe të parandalojë përthithjen e padëshiruar të ujit nga ambienti nëse ai është vajor.

Trajtimi me insekticid i drurit dhe substancat e përshtatshme për një disinfektim korrekt duhet të ndjekin këto faza:

- biocidi duhet të godasë direkt larvat dhe vezët në mënyrë që ti eliminojë totalisht.
- të gjitha zonat me sipërfaqe të ekspozuara duhet të trajtohen me insekticid dhe biocid të lëngshëm me penetrim të lartë për të krijuar një zonë me helm përmes të cilës do të kalojnë insektet ksilofag për të dalë në sipërfaqe.





- trajtimi sipërfaqësor duhet të përmbajë një shtresë insekticidi në sipërfaqe dhe në të gjitha carjet e drurit;

Ndërhyrja e dezinfektimit duhet të jetë e tillë që të eliminojë agjentët biologjikë negativë ekzistues dhe të parandalojë degradime të mundshme të materialit drusor në të ardhmen.

Solucioni do të aplikohet me spruco apo me penel, duke përsëritur trajtimin 2/3 herë rradhazi, për të lejuar insektin të penetrojë në dru sa më thellë të jetë e mundur. Duhet evituar përdorimi i produkteve në tretësirë ujore pasi kapaciteti i penetrimit varet nga lagështia e drurit.



Përpara përdorimit të insekticidëve (kanë avantazhin që nuk kanë erë), është e nevojshme lagia e drurit me ujë para çdo aplikimi. Me një 1kg insekticid mund të trajtohet një sipërfaqe prej 3m².

Insekticidët e shkrirë në tretës organik preferohen të kenë kapacitet të madh penetrimi në drurin e thatë përmes një procesi të shpërndarjes dhe përthithjes në thellësi. Insekticidet duhet të jenë eksperimentuar edhe më parë dhe të jenë të pranueshme nga praktika restauruese duke plotësuar kriteret që të jenë jotoksikë, rezistent ndaj dritës dhe rrezeve UV dhe të mos prodhojnë alterime kromatike.

Produktet e përdorshëm për desinfektim mund të jenë:

Desinfektimi i trarëve të çatisë – do të përdoren tretës në ujë vetëm në kushte të vecanta dhe do jenë me bazë të përzierjes së fluorit të natriumit dinitrofenol dhe bikromat, poliborat natriumi.

Kërpudhat – trajtimi antimyk (kundër kërpudhave) do parashikojë produkte efikas edhe kundër insekteve, do të trajtohet në përgjithësi produkte me bazë fluori të përbërë nga kromi dhe arseniku, pentaklorofenol etj. Është e rrallë që kërpudha të ketë kapacitet të zhvillohet në lagështi më të vogël se 22%, dmth vlera të lagështisë 12/14% përjashtojnë cdo rrezik, në cdo rast druri që do të përdoret duhet të jetë i stazhionuar.

Pas kryerjes së ndërhyrjes që garanton eliminimin dhe/ose parandalimin nga një nivel anomal lagështie, elementët drusor të infektuar dhe që nuk plotësojnë standartet teknike të përdorimit mund të hiqen apo digjen. Mund të rezultojë i nevojshëm të kryhet një ndërhyrje radikale nëpërmjet injeksioneve me biocid.

Shkalla e degradimit të elementëve drusorë do të gjykohet inspektimit dhe mbikqyrësi i punimeve do të vendosë mënyrën dhe llojin e aplikimit për elementët drusorë.





Në përgjithësi substancat antiseptike preferohen me fuqi të madhe të biocidit dhe të mos jenë të dukshëm pas aplikimit.

Përbërësit me fluor janë të përshtatshëm për eliminimin e kërpudhave.

Mund të jetë e nevojshme përdorimi i disa përzierësve për të arritur një përmirësim të biocidit.

Do të preferohen përzierje me bazë fluori apo dinitrofenol dhe florur natriumi (raport 11:89) me shtesë ose jo të arsenikut; përzierje të florurit me kripëra të arsenikut të natriumit;

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve për lyerjen e elementëve të drurit me insekticid e biocidë sipas metodologjisë dhe materialeve të përshkruar me të paktën dy duar, blerjen e materialit, transportin, skeleri dhe çdo punë që lidhet me të.

Ky çmim është lekë/ m².

2.3 Lyerje sipërfaqe druri me vaj lini (R.108)

Lyerja e elementëve drusorë do të bëhet për të mbrojtur këto elemente si dhe uniformizuar ngjyrën e të gjithë këtyre elementëve. Për elementët origjinalë të lyer me vaj lini do të pastrohet paraprakisht sipërfaqja nga pluhurat dhe depozitimet me kompresë me ujë të ngrohtë si dhe me alkool të holluar në ujë dhe më pas do të vazhdohet lyerja me vaj lini pa ngjyrë në mënyrë që të evidentohet ngjyra origjinale e elementëve. Për elementët drusorë të lyer me bojë vaji apo llak, do të bëhet pastrimi e zmerilimi i sipërfaqes sic e kemi shpjeguar më sipër në mënyrë që të arrihet përthithja e vajit të linit me ngjyrë të errët sipas ngjyrës së evidentuar të elementëve origjinalë. Vaji i linit duhet të jetë i shumë i pastër, me erë të fortë dhe shije të hidhur, i papërzier me vajëra mineral, vaj peshku apo të ndonjë lloji tjetër. Nuk duhet të lërë asnjë depozitim mbetje nëse e hedhim në lastër qelqi apo metal. Duhet të lihet të thahet komplet në intervalin e 24 orëve. Nuk duhet të ketë më tepër se 7% aciditet, 1% papastërti dhe në temperaturën 15°C një densitet 0.91-0.93. Lyerja duhet të bëhet me vaj lini.



Përpara fillimit të këtij procesi mbikqyrësi i punimeve të restaurimit, duhet të bëjë një kontroll të kujdesshëm të përcaktojë dhe lërë qartë detyrat kontraktorit për trajtimin e secilit element sipas përcaktimeve të mësipërme. Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve për lyerjen e elementëve të drurit me vaj lini të paktën dy duar, blerjen e materialit, transportin, skeleri dhe çdo punë që lidhet me të.

Ky çmim është lekë/ m².

2.4 Bojë vaji sipërfaqe metalike, kangjellat e dritareve (pastrim, lyrje me antirruks, 2d bojë vaji) (R.109)

Ky zë do të aplikohet në kangjellat metalike që ndodhen në dritaret në murin jugor dhe atë të





brendshëm dhe përfshin:

- Pastrimin me furçë teli dhe zmerilim i sipërfaqes së kangjellave metalike për eliminimin e ndryshkut që mund të kenë zënë me kalimin e kohës
- Investigimin e gjendjes së tyre pas pastrimit; nëse ka zona ku materiali mund të jetë shumë i ndryshkur dhe të mos jetë më në gjendje të kryejë funksionin e tij
- Trajtimin e tyre me antindryshk
- Lyerjen me bojë për sipërfaqe metalike

Ky çmim është lekë/ m².

2.5 Vendosje rrjetë metalike në dritare (3.766/1)

Ky zë përfshin vendosjen e rrjetave të holla metalike në pjesën e jashtme të dritareve dhe të këmbanarës, siç tregohet edhe në fletët grafike. Procesi i punës përfshin blerjen e materialit, transportin, aksesorët për vendosjen e tij në vepër dhe çdo proces tjetër që është i nevojshëm për përfundimin e procesit të punës.

Ky çmim është lekë/ m².

3 PUNIME SKELERIE

3.1 Pajantim i muraturës së dëmtuar me elemente druri (R.123)

Ky zë përfshin tërësinë e punimeve për të realizuar pajantimin e muraturës së dëmtuar dhe në vendet që do të nënshtrohen ndërhyrjeve, siç është parashikuar në fletët grafike, me qëllim përforcimin e strukturës së kishës, përpara se të fillojnë punime mbi muraturë.

Ky zë pune përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe çmimi i tij është për njësi Lekë/ m².

3.2 Punime puntelimi qemerë + shtresa mbrojtëse për pikturë (harkada në naos) (R.185)

Ky zë përfshin tërësinë e punimeve për të realizuar puntelimin e qemerëve të dëmtuar në pjesën e kolonadës së naosit, të cilat do të jenë subjekt i ndërhyrjeve restauruese. Me qëllim përforcimin e strukturës në pjesën e harkadave prej çatmaje të naosit, përpara se të fillojë procesi i çmontimit të çatisë, duhet të realizohet puntelimi. Fletët grafike paraqesin planin e puntelimit si dhe prerje tërthore të tij.

Ky zë pune përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe çmimi i tij është për njësi Lekë/ m².

3.3 Punime puntelimi (tavani i naosit) (R.186-an)

Ky zë parashikon vendosjen e puntelave për mbajtjen e tavanit të drurit në naos, të cilat do të vendosen sipas paraqitjes grafike, dhe në përputhje me udhëzimet e specialistit të tavanit të drurit dhe Supervizorit. Përpara puntelimit do të vendosen shtresat mbrojtëse të parashikuara nga restauratori i artit sipas projektit bashkalidhur.

Ky zë pune përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe çmimi i tij është për njësi Lekë/ m².

4 PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATIE

4.1 Restaurim çati tjegulla vendi (R.55)

Fillimisht do të bëhet çmontimi i kujdesshem i tjegullave duke shpëtuar ato që janë të padëmtuara e të forta konstruktivisht duke i seleksionuar me kujdes për tu ripërdorur më vonë.

Do të bëhet çmontimi me kujdes i petavrave të çatisë duke shpëtuar ato elemente drusor që janë të padëmtuar e të fortë konstruktivisht duke i seleksionuar me kujdes për tu ripërdorur më vonë.

Më tej kontrollohet cilësia dhe gjendja faktike e gjithë elementëve drusorë duke ruajtur elementët





Restaurimi i Kishës së Shën Mërisë, Bishqethëm, Lushnje



e mirë të strukturës mbajtëse bazë dhe duke zëvendësuar ndonjë element të degraduar dhe jashtë kushteve teknike për zbatim.

Plotësimi i elementëve të hequr, duke respektuar përmasat e konstruksionit të hequr dhe skemën tradicionale të çatisë. Gjendja e elementëve të konstruksionit do të kontrollohet nga mbikqyrësi i cili do të vendosë se cilët elementë do të ruhen dhe cilët jo. Trarët të cilët janë të degraduar ose janë të deformuar dhe ndikojnë në konstruksionin e çatisë, do të hiqen dhe do të ruhen për zëvendësimin e tyre me material të shëndoshë sipas përmasave, materialit dhe teknikës origjinale të elementit, ndërsa materialet e padëmtuara të cilat do të qëndrojnë në çati, do t'u nënshtrohen proceseve të konservimit duke iu nënshtuar një trajtimi dizinfektues ndaj agjentëve atmosferikë dhe krimbave e kërpudhave me antimol e insekticid dhe vaj lini. Trarët tërthorë të çatisë do të mbështeten mbi breza druri gjatësorë të vendosur mbi kreun e murit të gurit pas konsolidimit të tij. Rindertimi i dyshemesë së drurit do të bëhet me petavrat ekzistuese në gjendje të mirë. Elementët e dyshemesë të dëmtuara të zëvendësohen me elementë të rinj me përmasat dhe llojin e materialit të ekzistueses. Dyshemeja me petavra pas përfundimit do të trajtohet me solucion antimol, anti lagështirë, insekticid dhe në fund do të lyhet me 2 duar vaj lini.

Ky çmim është lekë/m².

4.2 Hidroizolim 1 k/katrama cati konstruksion druri (R.175)

Membrana hidroizoluese e çatisë do të përzgjidhet në konsultë me mbikqyrësin e punimeve në mënyrë që të përshtatet cilësia me kushtet specifike që kërkon çatia e një objekti të tillë. Kontraktori do të sjellë kampionë të ndryshëm të certifikuar, nëse ato nuk ofrojnë karakteristikat e kërkuara nga mbikqyrësi i punimeve do të refuzohen. Është mirë që këto membrana të sigurojnë ajrosje të çatisë.

Realizimi i shtresës hidro-izoluese do të bëhet mbi sipërfaqe të pastruar e tharë mirë të shtresës së petavrave duke përfshirë pjesën vertikale, do të jetë e përbërë nga një membranë guaine 4 mm, të vendosur në vepër mbi sipërfaqe të rrafshët, përfshirë mbivendosjen e lidhjeve minimumi 12 cm dhe do të ngrihet në drejtimin vertikal në muret anësorë me min. 10 cm. Kjo punë përfshin mbërthimet heqjet, spostimet si dhe çdo detyrim tjetër të nevojshëm për ti dhënë fund procesit.

Sugjerohet që shtresa hidroizoluese të sigurojë hidroizolim absolut kundër ujit dhe lagështisë. Gjithashtu duhet të ketë një depërtueshmëri të kënaqshme të avullit që lejon kalimin e avullit por jo të ujit. Duhet të ketë peshë të lehtë dhe rezistencë të lartë mekanike. Rezistencë ndaj ndryshimeve të temperaturës. Rezistencë të lartë ndaj zjarrit.

Ky çmim është lekë/m².

5 PUNIME SISTEMIM TERRITORI





5.1 Germim e mbushje dheu me krah kat III per themele, $h=1.5m$ per drenazh (R.2)

- Mbrojtja e punimeve të dheut

Tek punimet me dheun duhet nga njëra anë të mbrohen njerëzit, të cilët nuk janë të përfshirë në ndërtimin e projektit, e nga ana tjetër duhet të mbrohen njerëzit e inkuadruar në realizimin e projektit. Gjithashtu, duhet mbrojtur gropa e hapur për themelet.

Mbrojtja e njerëzve të painkuadruar duhet bërë në atë mënyrë që të bëhet rrethimi (me gardh, rrjetë gabiant etj.) i cili nuk i lejon ata të rrezikohen. Gjithashtu, duhet vendosur tabela paralajmëruese me të cilën ndalohet kalimi i rrethimit nga persona që nuk punojnë në projekt. Gropa dhe njerëzit që janë duke e punuar atë, duhen mbrojtur ndaj shembjes.

Gjatë gjithë procesit të gërmimit, duhet patur kujdes që ai mos të ndikojë në qëndrueshmërinë e strukturës, dhe themelet të jenë të plota dhe të qëndrueshme. Nëse në ndonjë rast gërmimi i parashikuar në projekt, shkon në një thellësi nën tabanin e themelit, atëherë duhet që themeli të plotësohet me gurë dhe llaç. Ky proces duhet të autorizohet nga Supervizori.

- Mbushjet

Të gjitha materialet që rezultojnë nga prishjet, do të kontrollohen më parë nga Supervizori dhe ripërdorimi i tyre do të autorizohet nga ai.

- Përdorimi i materialit të gërmuar

Materiali i përshtatshëm dhe materiali i rimbushur nga punë të përkohshme do të përdoren për rimbushje dhe nivelim. Çdo material i tepërt do të jetë në dispozicion të mungesave të materialeve të kërkuara.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m^3 .

5.2 Prishje shtresë betoni (R.214)

Prishja e shtresës së betonit, do të kryhet në shtrimin që ndodhet përpara hyrjes në jug. Ky zë përfshin prishjen e shtresës dhe transportin e materialit.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m^3 .

5.3 Shtresë llaçi horasan për themelet (R.161)

Shtresa e llaçit do të realizohet përgjatë muraturës, pas gërmimit dhe pastrimit të themeleve. Për detajin e drenazhit referoju fletëve grafike.

Përbërja e llaçit horasan:

Rërë lumi e larë	2 pjesë
Rërë vullkanike me granulacion 0,5-1 cm	2 pjesë
Pluhur tulle dhe copa tulle deri në 2 cm	2 pjesë
Gëlqere e vjetër	3 pjesë

Pasi realizohen proceset e mësipërme të përgatitjes së llaçit horasan, mund të vazhdohet me vendosjen/ngjitjen e letres katrama për h/izolimim e themeleve. Procesi i punës do të zhvillohet sipas detajit në fletët grafike.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m^3 .





5.4 Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 k katrama (R.35)

Membrana që do të vendoset për hidrozolim e themeleve do të përzgjidhet në konsultë me mbikqyrësin e punimeve në mënyrë që të përshtatet cilësia me kushtet specifike që kërkohen. Kontraktori do të sjellë kampionë të ndryshëm të certifikuar, nëse ato nuk ofrojnë karakteristikat e kërkuara nga mbikqyrësi i punimeve do të refuzohen. Është mirë që këto membrana të sigurojnë ajrosje.

Realizimi i veshjes hidro-izoluese do të bëhet mbi sipërfaqe të pastruar e tharë dhe pasi sipërfaqja është lyer me llaç horasan dhe do të jetë e përbërë nga një membranë guaine 4 mm, të vendosur në vepër mbi sipërfaqe të rrafshët, në drejtimin vertikal në muret anësorë me min. 50 cm. Kjo punë përfshin mbërthimet, heqjet, spostimet si dhe çdo detyrim tjetër të nevojshëm për ti dhënë fund procesit.

Sugjerohet që shtresa hidroizoluese të sigurojë hidroizolim absolut kundër ujit dhe lagështisë. Gjithashtu duhet të ketë një depërtueshmëri të kënaqshme të avullit që lejon kalimin e avullit por jo të ujit. Duhet të ketë peshë të lehtë dhe rezistencë të lartë mekanike. Rezistencë ndaj ndryshimeve të temperaturës. Rezistencë të lartë ndaj zjarrit.

Ky çmim është për njësi Lekë/m².

5.5 Suva brenda mur tulle me krah, llaç gëlqere 1:2 (R.87)

Ky zë parashikon vendosjen e një shtrese suvaje në zonën ku do të bëhet drenazhimi, sipas detajit në fletët grafike. Shtresa e suvasë do të jetë 3 cm, dhe do të shërbejë si shtresë mbrojtëse e hedhur mbi muraturën me tulla që do të vendoset si brez mbrojtës për infiltrimin e ujrave, dhe mbi të cilën do të ngjitet letra e katramasë.

Në çmim përfshihet, suvatimi i muraturës me llaç gëlqere 1:2, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 3 cm llaçi gëlqere 1:2, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m), dhe e lëmuar me mistri e bërda, duke përfshirë skelat e shërbimit, transporti i materialeve si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

Ky çmim është për njësi Lekë/m³.

5.6 Mur me tulla të plota deri 3 m, llaç gëlqere 1:3, 10 cm (R.13)


Muri me tulla do të vendoset përgjatë themelit të gurit, pasi të jetë vendosur shtresat e llaçit, katramasë dhe suvasë. Ky brez me mur tulle do të vendoset në mënyrë që të realizohet një hidroizolim më i mirë i themeleve dhe të mos ketë dëmtime nga shtresave nga hedhja e çakëllit.

Ky çmim është për njësi Lekë/m³.

5.7 Nënshtrësë zhavorri 10 cm (R.63)

Ky zë përfshin blerjen e materialit të zhavorrit, si dhe vendosjen në vepër. Shtresa e zhavorrit është parashikuar të vendoset në të gjithë sipërfaqen që do të realizohet drenazhi. Do të bëhet ngjeshja dhe nivelimi i shtresës.

Ky çmim është për njësi Lekë/m³.





5.8 Shtresë betoni 10 cm (R.67)

Ky zë përfshhet në realizimin e drenazhimit sipas fletëve grafike:

- Përgatitjen dhe hedhjen e tij në vepër mbi shtresat e përgatitura më parë dhe i formuar nga shtresa të holla të vibruara mirë, duke përfshirë çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës në mënyrë të rregullt.
- Çdo gjë tjetër të nevojshme për përfundimin e punës dhe realizimin e saj në mënyrë të rregullt.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m^3 .

5.9 F.V. Tub drenazhi $\varnothing$ 150 (R.153)

Drenazhimi do të bëhet përgjatë themeleve. Ky drenazhim përbëhet nga linja unazore me tuba shkarkimi me diametër 150 mm dhe puseta e kontrollit.

Për tu realizuar drenazhi, duhet që në këtë zonë tabani i themeleve të jetë më i thellë.

Tubat do të shtrihen duke u nisur nga pika më e ultë, deri në pikën më të lartë në vijë të drejtë me pjerësi, mbi një shtresë filtruese zhavorri 10 cm të trashë dhe të mbulohet rreth 25 cm me të njëjtin material filtrues. Gjithashtu tabani i tubit do të jetë nën nivelin e dyshemesë sipas paraqitjes grafike, në mënyrë të tillë që uji të largohet pa problem nga shtresat faktike.

Dimensionet e tubit duhet të jenë 150 mm, zhavorri që do të përdoret për shtresën filtruese duhet të jetë me kokrriza jo më të vogla se 3.2 mm.

Zëri përfshin furnizimin dhe vendosjen në vepër të tubit të drenazhit, dhe çdo proces tjetër të nevojshëm për përfundimin e punës dhe realizimin e saj në mënyrë të rregullt.

Ky çmim është për njësi Lekë/ml.

5.10 Mbushje me çakëll (3.207)

Ky zë përfshin blerjen e materialit të çakëllit, vendosjen dhe nivelimin e tij në vepër. Mbushja me çakëll është parashikuar të realizohet si shtresë për realizimin e drenazhit, sipas përcaktimeve në fletët grafike.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m^3 .

5.11 Shtresë rëre (R.64)

Ky zë përfshin blerjen e materialit të rërës si dhe vendosjen në vepër. Shtresa e rërës është parashikuar të vendoset si shtresë për vendosjen e kalldrëmit. Do të bëhet ngjeshja dhe nivelimi i shtresës.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m^3 .

5.12 Shtresë kalldrëmi 15-20 cm mbi shtresën e rërës (R.65)

Shtrimi i trotuarit përreth kishës do të bëhet me shtresë kalldrëmi. Punimet do të kryhen në këtë mënyrë:

Përmbi bazën do të vendohet një shtresë rëre me një trashësi maksimale prej 5 cm, do të vendosen gurët e kalldrëmit. Shtresa e rërës duhet të jetë me kokrriza 2/5 mm deri 0/4 mm. Ajo do të rrafshohet dhe mbi të duhet të vendosen gurët e kalldrëmit.





Në fund fugat e gurëve do të mbushen me rërë të imët 0/1 mm në atë mënyrë që gurët të lidhen më së miri njëri me tjetrin dhe të përforcohet/stabilizohet shtresa e tyre.

Karakteristikat e gurëve të kalldrëmit duhen marrë prej prodhuesve. Ato variojnë si në trashësi ashtu edhe në dimensionet e tjera. Po ashtu edhe ngjyrat e tyre janë të ndryshme. Projektuesi së bashku me Mbikqyrësin e punimeve duhet të bien në marrëveshje ndaj modelit, dimensioneve dhe ngjyrës së gurëve.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

5.13 Pusetë shkarkimi b/a, 80x80 cm, h=100 cm (An-19)

Ky zë përfshin realizimin e pusetës së shkarkimit të ujrave të shiut dhe drenazhit, siç është parashikuar në fletët grafike. Muret e pusetës do të jenë me beton të derdhur në vend. Ndiqet procedura e mëposhtme e punës:

- Gërmim me seksion të caktuar në terren
- Shtresë zhavorr lumi
- Shtresë betoni të padepërtueshëm nga uji me beton m-200
- Muraturë betoni të padepërtueshme nga uji me beton m-200
- Shtresë e sipërme betoni e padepërtueshme nga uji me beton m-200
- Vendosja e kornizës dhe kapakut të pusetës, e cila do të jetë prej gize.

Puseta duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme teknike:

- Ngarkesën e mbajtjes së jashmte, e kalsës B
- Presionin e dheut, me koef. 2 t/m³
- Presionin e ujit duhet të jetë 1t/m³

Ky çmim është për njësi Lekë/ copë.

5.14 Vendosja e nje table treguese per vendndodhjen e monumentit (qe do te vendoset ne rrugen nacionale) (An.157)

Ky çmim përfshin furnizimin dhe vendosjen e një table drejtuese për në monument, me dimensione 60*20 cm, dhe me përmasa dhe ngjyrë sipas sinjalistikës rrugore. Tabela do të vendosen në fillim të rrugës lokale. Vendosja e panelit informues do të realizohet në bashkëpunim me Investitorin, pas konsultave në vend.

Ky çmim është për njësi Lekë/ copë.

5.15 Vendosja e nje table shpjeguese per monumentin (qe do te vendoset ne hyrje te rrethimit) (An.159)

Ky çmim përfshin furnizimin dhe vendosjen e një paneli informues mbi monumentin. Paneli do të vendoset në hyrjen e rrethimit ekzistues të kishës dhe do të përfshijë informacione të përgjithshme dhe do të jetë në gjuhën shqip. Format i panelit informues do të jetë 55 x 70 cm. Paneli është me kornizë metalike ndërsa formati adeziv nën plexiglass. Vendosja e panelit informues do të realizohet në bashkëpunim me Investitorin, pas konsultave në vend.

Ky çmim është për njësi Lekë/ copë.





5.16 F. V Bombula për mbrojtjen nga zjarri

Ky çmim përfshin furnizimin dhe vendosjen e bombulave kundra zjarrit në ambientet e brendëshme të kishës.

Ky çmim është për njësi Lekë/ copë.

6 PUNIME ELEKTRIKE

Punimet elektrike konsistojnë në një rehabilitim total duke i zëvendësuar instalimet e vjetra në përputhje me normat dhe kushtet teknike të zbatimit. Në projekt do të parashikohen pajisjet e nevojshme dhe të domosdoshme sipas ngarkesës dhe parametrave teknik. Në këtë çmim përfshihet tërësia e punimeve, blerja e transporti i materialeve, vendosja e tyre dhe prova me ngarkesë pas përfundimit (shtrirjen e telave e kabllove të ndryshme për realizimin e instalimeve në standarte bashkekohore, celesa, priza, llampa, portollamba, të cilat do të instalohen nepermjet kutive shperndarese të vendosura në mur me anë të kanelinave, kutive të automateve me llamba sinjali etj) si cdo punim tjetër të nevojshëm për të përfunduar me sukses punimet elektrike.

Gjithcka do të jete sipas normales C.E.I sipas certificates normale konforme. Të gjitha telat dhe kabllo të duhet të kenë çertifikatën e aprovimit të autoriteteve lokale përkatëse dhe çertifikatën e fabrikës. Telat duhet të jenë përçues të thjeshtë bakri të izoluar (veshura) me shtresë teke PVC për tu futur brenda tubave dhe linjave. Izolimi i telave dhe këllëfi duhet të jenë me izolim të ngjyrosur për të identifikuar fazën dhe nulin. Të gjitha rastet kur kabllo PVC përfundojnë në një panel shpërndarës siguresash, pajisje elektrike etj, duhet lënë një sasi kabli të lirshëm për të lejuar në të ardhmen, zhveshjen e rilidhjes me terminalet pa shkaktuar tërheqje të tyre. Kabllo për çdo seksion të instalimit duhet të mbyllen nëpër tuba dhe në sistemin e kutive futëse përmbledhëse për atë ndarje të veçantë. Zhveshja e izolimit në kabllo të izoluar me PVC duhet të kryhet duke përdorur një vegël të përshtatshme për zhveshjen, dhe jo një thikë. Kanalet dhe aksesorët Instalime elektrike të bëhen të maskuara të futura në tuba PVC fleksibël.

6.1 Kanalinë metalike 150*50 (2.a-121)

Ky çmim është për njësi Lekë/ ml.

6.2 F.V. kuadër ndriçimi (2.490)

Ky çmim është për njësi Lekë/ copë.

6.3 F.V Automat sekondar me 4 vende (2.490/a)

Ky çmim është për Lekë/ copë.

6.4 F.V. Siguresa ~25 A (2.489)

Ky çmim është për njësi Lekë/ copë.

6.5 F.V Kasetë plastike KE me 6 modular (vende) (2.490/b)

Ky çmim është për njësi Lekë/ copë.

6.6 F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 10A (2.490/1a)

Ky çmim është për njësi Lekë/ copë.

6.7 F.V përcjellës PV-500 Ø 2.5 mm² (2.481/2)

Ky çmim është për njësi Lekë/ ml.

